



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

19.04.2013

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Tërheqet nga shitja Njësia nr. 05: Tokë dhe objekt dhe Njësia nr. 06: Tokë – Runikë, Komuna e Skenderajt

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga shitja Njësinë nr. 05: Tokë dhe objekt dhe Njësinë nr. 06: Tokë, që gjenden në Zonën Kadastrale Runik të Komunës së Skenderajt.

Këto dy njësi ishin tenderuar për t'u shitur përmes shitjes së aseteve nr. 19, që do të mbahet me datë 24 prill 2013.

Tërheqja nga shitja e këtyre aseteve është bërë me kërkesë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë-Komuna e Skenderajt dhe Autoriteti i Likuidimit në Agjenci e ka paraqitur kërkesën për udhëzim tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, prandaj është pezulluar shitja e aseteve në fjalë deri në përgjigjen e Dhomës së Posaçme.

Afati i fundit për para-kualifikim për të marrë pjesë në tenderin e shitjes së aseteve në likuidim nr. 19 është data 17 prill 2013. Dita për dorëzimin e ofertave për asetet në vijim është 24 prill 2013, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të aseteve të parapara për shitje përmes Likuidimit Nr. 19:

Njësia nr. 01: Ramadan Agushi Toka në Pustenic - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë një sipërfaqe të tokës kryesisht bujqësore, e përshtatshme për kultivimin e bimëve të ndryshme bujqësore. Pasuria e ofruar për shitje është pronë tokësore me sipërfaqe prej rreth 171139 m² (17 ha 11 ari 39 m²). Prona përbehet nga parcelat me nr. 528, 534, 535, 536, 543, 544, 545, 546, 547, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 955, 956, sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-73317070-00098.

Njësia nr. 02: Ramadan Agushi Toka në Rezhanc - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë një sipërfaqe të tokës kryesisht bujqësore, e përshtatshme për kultivimin e bimëve të ndryshme bujqësore. Pasuria e ofruar për shitje është pronë tokësore me sipërfaqe prej rreth 19021 m² (1 ha 90 ari 21 m²). Prona përbehet nga parcelat me nr. 11 dhe 12, sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-73317073-00077.

Njësia nr. 03: Dyqani i IMB me ndërtim të përkohshëm te Kazerma - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

dyqanin me ndërtim të përkohshëm, që sipas Vendimit komunal për lejjimin e ndërtimit është me sipërfaqe 42.33 m², ndërsa pas matjeve në teren sipërfaqja është rreth 48,41 m² me vendndodhje në rrugën “UÇK” në afërsi të Kazermës dhe Gjimnazit e Shkollës Ekonomike në Mitrovicë. Dyqani është i përshtatshëm për qëllime tregtare.

Njësia nr. 04: Dyqani i IMB me ndërtim të përkohshëm në Kodrën e Minatorëve – Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë dyqanin me ndërtim të përkohshëm, që sipas Vendimit komunal për lejjimin e ndërtimit është me sipërfaqe rreth 71.42 m² me vendndodhje në lagjen “Kodra e Minatorëve”(Mikronasele) në rrugën “Milan Shuflai” në veri të Mitrovicës.

Këto të dhëna janë marrë nga dokumentet pasi që ne nuk kemi qasje në pronën e cila do të tenderohet , i mbetet blerësit të ri të merret me këtë çështje.

Njësia nr. 07: NBI Suhareka - Prona në Dubravë 3 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë pronën që është e regjistruar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-72116018-00044, që ndodhet në Zonën Kadastrale Dubravë, Komuna e Suharekës, ngastrat kadastrale nr. P-72116018-00157-1; P-72116018-00158-0 dhe P-72116018-00159-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 133564 m². Kjo sipërfaqe përfshin tokë bujqësore.

Njësia nr. 08: Kosovarja Minimarketi nr.1 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 102 m², sipas kontratës, kurse sipas gjendjes faktike përfshinë sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 136 m². Lokali afarist gjendet afër qendrës tregtare në Breg të Diellit Rr. Hyzri Talla, në Prishtinë.

Njësia nr. 09: Kosovarja Shitorja nr.22 Lipjan - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 66.5 m² që gjendet në katin përdhes në të ndërtesës shumëkatëshe në qendër të Sheshit Adem Jashari në Lipjan.

Njësia nr. 10: IMF Kosova Shitorja nr.13 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 55 m², e cila gjendet në një pjesë atraktive të Prishtinës, në lagjen Ulpiana përballë IPKO-s.

Njësia nr. 11: IMF Kosova Shitorja nr.14 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 93.7 m², e cila gjendet në një pjesë atraktive të Prishtinës, në lagjen Ulpiana, afër fontanës. Nuk ka tokë që do ti transferohet blerësit të ri. Shënim me rëndësi: Ofertuesit duhet të jenë të njoftuar se sipërfaqja e lokalit që do ti bartet blerësit të ri është vetëm sipërfaqja prej përafërsisht 93.7 m². Pjesa tjetër e lokalit me sipërfaqe prej përafërsisht 17.6 m² e cila është ndërtuar si aneks nga shfrytëzuesit, nuk është pjesë e kësaj njësie.

Njësia nr. 12: IMF Kosova Shitorja nr.2 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

përafërsisht 63.74 m², e cila gjendet në katin përdhes në kuadër të ndërtesës shumëkatëshe për banim në Rr. Nëna Terezë përball Rektoratit të Kosovës, një pjesë atraktive e qendrës së Prishtinës.

Njësia nr. 13: Gërmia Shitorja nr. 3 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist të ndarë në dy pjesë me sipërfaqe prej përafërsisht 34 m². Aseti gjendet një pjesë atraktive të Prishtinës, në rrugën Ardian Krasniqi përball Zyrës Zvicerane.

Njësia nr. 14: Gërmia Shitorja nr. 206 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 298.90 m², e cila përbëhet nga lokali i cili ka një sipërfaqe të përafërt prej 130 m², podrumi me sipërfaqe të përafërt prej 150.90 m² dhe një hapësirë në mes të kateve e cila shfrytëzohet si zyre me sipërfaqe prej përafërsisht 18 m². Aseti gjendet në katin përdhes në kuadër të ndërtesës shumëkatëshe për banim në një pjesë atraktive të Prishtinës, në rrugën Agim Ramadani.

Njësia nr. 15: Gërmia Depot te Hekurudha - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë depot 5,7,8,9 dhe 10 me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 1899 m² prej të cilave, kati përdhes depot 5,7,8 me sipërfaqe prej përafërsisht 1108 m² dhe bodrumi depot 9 dhe 10 me sipërfaqe prej përafërsisht 791 m² të cilat gjenden pran hekurudhës së qytetit të Prishtinës.

Njësia nr. 16: Gërmia Shitorja nr. 194 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 26 m² që gjendet në rrugën "Ilir Konushevc" në Prishtinë.

Njësia nr. 17: Gërmia Shitorja nr. 5 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 62 m² i cili gjendet në një pjesë atraktive në Rr. "UCK", afër ProCredit Bank, në Prishtinë.

Njësia nr. 18: Gërmia Shitorja nr. 188 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 56 m², i cili gjendet në një pjesë atraktive në Rr. "UÇK" afër ProCredit Bank në Prishtinë.

Njësia nr. 19: Gërmia Shitorja nr. 6 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 32 m² i cili gjendet në rrugën UÇK, afër ProCredit Bank.

Njësia nr. 20: Gërmia Shitorja nr. 193 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 63 m² prej të cilës 32 m² përdoret për lokal dhe 31 m² për depo. Shitorja gjendet në rrugën "UÇK", në katin përdhese të objektit të banimit kolektivë në Prishtinë.

Njësia nr. 21: Gërmia Shitorja nr. 201 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 33 m² prej të cilave 24 m² lokal afarist dhe 9 m² depo. Shitorja gjendet në rrugën "UÇK", në katin përdhese

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

të objektit të banimit kolektivë në Prishtinë.

Njësia nr. 22: Gërmia Shitorja nr. 58 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 24 m². Shitorja gjendet në sheshin “Nëna Tereze”, përball objektit të Ministrisë së Kulturës, në katin përdhese të objektit të banimit kolektivë në Prishtinë.

Njësia nr. 23: Gërmia Marketi në Fushë Kosovë - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me ndërtim të fortë prej përafërsisht 119 m², dhe gjendet në një pjesë atraktive për veprimtari të ndryshme biznesi, përball stacionit të trenit në Fushë Kosovë.

Njësia nr. 24: Urata Shitorja në Çagllavicë - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 137 m². Lokali gjendet në katin përdhese të një ndërtese dykatëshe, në qendër të fshatit Çagllavicë, afër Ambulancës së fshatit.

Njësia nr. 25: Urata Shitorja nr. 42 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me sipërfaqe prej 56.5 m² dhe tokë me sipërfaqe prej 56.5 m², që gjendet në kryqëzimin e rrugëve Haxhi Zeka dhe Taip Krasniqi në Prishtinë, përball Muzeut të Kosovës. Prona e ofruar për shitje (toka dhe lokali afarist) është e regjistruar në Certifikatën e Pronës nr. 47041, parcela nr. 5641/0, Zona Kadastrale Prishtinë, në të cilën NSH Urata është bashkëpronare në ½ pjesë ideale të pronës.

Njësia nr. 26: Depoja e Lirisë - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalin afarist me një sipërfaqe rreth 44 m² prej materiali të fortë dhe tokën me sipërfaqe rreth 56 m². Objekti është ë përdorshëm për aktivitete komerciale të ndryshme. Aseti ndodhet në Rr. Hoxhë Tasini në Komunën e Pejës.

Njësia nr. 27: Objekti i 17 Nëntorit (e njohur si Gjykata për Kundërvajtje) - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë hapësirën etazhike me sipërfaqe të përafërt 321 m² dhe hapësirën në përdhes me sipërfaqe të përafërt prej 67 m² që shfrytëzohet nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Pejë. Aseti gjendet në Çarshinë e Gjatë në Komunën e Pejës.

Njësia nr. 28: Dyqani në Çarshi Gjakovë - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë tokën në sipërfaqe prej 33 m² dhe objektin në sipërfaqe të përafërt 56 m². Aseti ndodhet në Çarshi në Komunën e Gjakovës.

Njësia nr. 29: NSH Ballkan - Njësia Goma, Prishtinë – Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë token dhe objektin që ndodhen në një pjesë shumë atraktive të Prishtinës respektivisht në zonën Industriale të Prishtinës. Prona e lartshënuar është e regjistruar në emër të N.SH “Ballkan” në bazë të Çertifikatës mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. P—71914059-02893-2 dhe

Rr. Ilir Konushevcu No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

përfshinë një sipërfaqe të përgjithshme prej 9700 m² (97 ari) nga të cilat 980 m² janë me kulturë ndërtesë ndërsa 8720 m² me kulturë oborr. Mirëpo, sipërfaqja e objekteve të cilat në terren paraqesin një tërësi dhe kanë lidhje të vazhdueshme në mes veti, sipas matjeve interne të AKP-së rezultojnë të jenë 1533 m².

Njësia nr. 30: Dyqani Galenteri Mode - 1 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist të njohur si "Galenteri Mode-1" me sipërfaqe të përafërt 41 m² që ndodhet në përdheshën e bllokut banesor në Rr. Mbretëresha Teutë nr. 53 në qendër të qytetit në Komunën e Pejës.

Njësia nr. 31: Shitorja nr. 20 - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist të shitjes me pakicë me sipërfaqe rreth 50 m². Dyqani gjendet në rr. Viktimat e Pejës në lagjen Dardania, në Komunën e Pejës.

Njësia nr. 33: Barnatorja Bujqësore Pejë - Ky aset u ofron investitorëve potencialë mundësinë për të blerë lokalit afarist me sipërfaqe rreth 76 m² që ndodhet në Qendrën Zejtare në Komunën e Pejës. Lokali ndodhet në katin përdhesh të një shtëpie private dhe njihet si barnatore bujqësore.

FUND